

 Menu

HOME > NEWS

Krijimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë

19 October, 2021 by **KLJGJ** in **QTI**

Sot, në datën 19.10.2021, u zhvillua takimi i parë i Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë. Ky takim shënoi krijimin e Qendrës, si institucion publik, me personalitet juridik dhe ka për mision caktimin e standardeve dhe politikave në përputhje me rregullat për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit dhe të dhënave (pajisje dhe programe), duke siguruar përmbushjen e nevojave të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Bordi Drejtues deklaroi ngritjen e tij me përbërje si më poshtë:

1. Znj. Naureda Llagami, Kryetare
2. Z. Vatë Staka, Zëvendëskryetar
3. Z. Artur Metani, anëtar



4. Z. Skënder Dauti, anëtar
5. Z. Luan Abazi, anëtar
6. Z. Gentian Deva, anëtar
7. Z. Sotir Kllapi, anëtar
8. Z. Genti Xholi, anëtar
9. Znj. Elsa **Ulliri**, anëtare
10. Z. Erjon Bani, anëtar
11. Z. Julian Haxhiu, anëtar

Në vijim të vendimmarrjes së mësipërme u deklarua krijimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, si momenti nga i cili fillojnë efektet juridike dhe funksionet e këtij institucioni, i cili angazhohet të sigurojë përmbushjen e plotë të misionit të Qendrës, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efiçencës.

Në përfundim, Bordi vendosi shpalljen e procedurave për rekrutimin e Drejtorit Ekzekutiv në Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.





[Previous](#)

Njoftim për shtyp, datë 19 Tetor 2021

[Next](#)

Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Misionin EURALIUS V zhvilloi një takim me përfaqësuesit e gjykatave të rretheve gjyqësore, për të diskutuar mbi masat e nevojshme për rritjen e efencës në sistemin gjyqësor

